

KULTURA 2023



Nr.22

BULETINI MUJOR / TETOR

kultura.gov.al



RIHAPET SALLA E RESTAURUAR KONCERTEVE NË UNIVERSITETIN E ARTEVE

Në një atmosferë të ngrohtë, mes miqsh, artistë, pedagogë, studentë, me praninë e kryeministrit Edi Rama u dha shfaqja e parë në sallën e rinovuar të Universitetit të Arteve, Tiranë. U desh të kalonin shumë dekada deri në rikonstruksionin total të Sallës së Koncerteve në Universitetin e Arteve. Ndër vite është tentuar të bëhen rregullime aty-këtu, por kanë qenë thjesht arna në sallën monumentale të ndërtuar nga italianët në vitin 1942. Rikonstruksioni i Sallës së Akademisë së Arteve ishte shprehje e vullnetit të qeverisë shqiptare për t'iu përgjigjur kërkesave të vazhdueshme të artistëve dhe studentëve; një fjalë e mbajtur në Paktin për Universitetin. Një investim i munguar, i mundësuar me miq të mirë, në bashkëpunim me TAP-in. Një investim prej

NJË INVESTIM PREJ 3,7 MILIONË EUROSH, PREJ TË CILAVE TAP-I KA FINANCUAR 1,7 MILIONË EURO, NDËRSA PJESA TJETËR, 2 MILIONË EURO, ËSHTË FINANCIM NGA QEVERIA SHQIPTARE.

3,7 milionë eurosh, prej të cilave TAP-i ka financuar 1,7 milionë euro, ndërsa pjesa tjetër, 2 milionë euro, është financim nga qeveria shqiptare. Ka qenë një proces i gjatë dhe i vështirë, pasi duhej gjetur formula e duhur për të integruar teknologjinë më të fundit në një godinë monument kulture. Për këtë na kanë asistuar profesorët e Universitetit të Arkitekturës në Firence, mjeshtër në ruajtjen e trashëgimisë kulturore. Nga ana tjetër, ka qenë një punë e gjatë kërkuese në arkiva shqiptare e italiane për të gjetur çdo informacion që mund të na shërbente për ruajtjen e autenticitetit të godinës. Dhe sot kemi një sallë - trashëgimi kulturore, që flet me teknologjinë e kohës, funksionale dhe e denjë për artistët e skenës dhe publikun.



ZBULOHEK MOZAIKU I RRALLË NË DURRËS

Gjatë rindërtimit të shkollës së mesme "Gjergj Kastrioti", janë zbuluar gjetje arkeologjike tepër të rëndësishme si për nga tipologjia, ashtu edhe me vetë historinë e zhvillimit të qytetit antik. Bëhet fjalë për një bazament kolone, fragmente muresh, fragmente potenciale të pikturës murale e fragmente mermeri, që nga vlerësimi paraprak përkojnë me elemente tipike të strukturës së një vile romake. Por gjetja kryesore është një mozaik floreal, që nëntoka e ka ruajtur në një gjendje mjaft të mirë, i periudhës së hershme perandorake romake, që në fazën aktuale, mendohet të mbulojë një sipërfaqe prej afro 30 m2. Hulumtimi i mëtejshëm pritet të zbulojë edhe elemente të tjera të rëndësishme të sitit arkeologjik.



VARRET MONUMENTALE TË IDROMENOS E MARUBIT I NËNSHTROHEN RESTAURIMIT

Këshilli Kombëtar i Trashëgimisë Kulturore Materiale miratoi projektin e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese në varrin monumental të piktorit dhe fotografit Kolë Idromeno dhe të varrit monumental të familjes Marubi, në Varrezat e Rrmajit në Shkodër. Pastrimi, konsolidimi, rimodelimi dhe plotësimi i elementeve dekorative që mungojnë janë disa nga ndërhyrjet që do të kryhen, duke synuar ruajtjen e këtyre monumenteve simbolike ku prehen disa nga figurat më të shquara të arteve pamore shqiptare. Kjo ndërhyrje është në vazhden e projekteve për mirëmbajtjen dhe restaurimin e monumenteve të kulturës në zonën e Shkodrës.

VILA 31 SHNDËRROHET NË REZIDENCË ARTISTËSH, NËNSHKRUHET MARRËVESHJA ME "ART EXPLORA"

Vila 31, ish-vila e diktatorit Enver Hoxha, do të përfshihet në një projekt artistik që do ta shndërrojë atë në një rezidencë arti. Në praninë e



Presidentit të Republikës Franceze z. Emmanuel Macron, kryeministrit shqiptar z. Edi Rama, ministres së Kulturës të Francës znj. Rima Abdul-Malak, asaj shqiptare znj. Magariti dhe artistëve të ftuar, u nënshkrua marrëveshja për zhvillimin e projektit artistik "Vila Art Rezidencë Tirana" në Vilën 31 (ish-vila e diktatorit Enver Hoxha).

Marrëveshja u nënshkrua mes Ministrisë së Kulturës të Shqipërisë, Drejtorisë së Shërbimeve Qeveritare dhe Fondacionit Francez "Art Explora". Projekti synon të krijojë një hapësirë për artistët dhe publikun për të shkëmbyer përvoja historike, kulturore dhe njerëzore në kuadrin e zhvillimit të artit dhe kulturës, në hapësira që gjatë historisë ishin të rezervuara vetëm për një grup të ngushtë njerëzish. Po ashtu, të transformojë rezidencën e familjes së diktatorit në një mjedis gjithëpërfshirës dhe bashkëpunues, ku artistët me prejardhje multietnike dhe kulturore mund të bashkohen dhe të shkëmbejnë ide, art, histori dhe solidaritet.

SHQIPËRI-FRANCË, MARRËVESHJE NË FUSHËN E KINEMATOGRAFISË

Ministria e Kulturës dhe Qendra Kombëtare e Kinematografisë Franceze nënshkruan një marrëveshje bashkëpunimi në fushën e kinematografisë. Gjatë Samitit të Berlinit që u mbajt në Tiranë, ministrja e Kulturës znj. Elva Magariti priti ministren e Kulturës të Republikës së Francës znj. Rima Abdul-Malak. Kinematografia ishte një nga temat e diskutimit. Kjo e fundit ishte edhe objekt i marrëveshjes së nënshkruar mes Ministrisë së Kulturës dhe Qendrës Kombëtare të Kinematografisë Franceze. Nga kjo marrëveshje do të përfitohet asistencë dhe ekspertizë në procesin e rishikimit të ligjit për kinematografinë; mundësi trajnimi për kineastët e rinj dhe punonjësit e sektorit, për të shkuar drejt një marrëveshje bashkëprodhimi vitin që vjen. Marrëveshja e bashkëpunimit u nënshkrua mes ministres së Kulturës të Republikës së Shqipërisë znj. Elva Magariti dhe z. Dominique Boutonnat, President i Qendrës Kombëtare për Kinemanë dhe Imazhet e Animuara (CNC).

MARRËVESHJA
NGA KJO MARRËVESHJE DO TË PËRFITOHET ASISTENCË DHE EKSPERTIZË NË PROCESIN E RISHIKIMIT TË LIGJIT PËR KINEMATOGRAFINË, MUNDËSI TRAJNIMI PËR KINEASTËT E RINJ DHE PUNONJËSIT E SEKTORIT

LULJETA LLESHANAKU PËRZGJIDHET POETE LAUREATE

Luljeta Lleshanaku për zgjidhet si Poetja Laureate në edicionin e dytë të këtij titulli. Mes një liste të gjatë kandidaturash, emra të shquar të poezisë shqipe, propozuar nga komisioni përzgjedhës, Lleshanaku u



shpall si më e votuara. Përgjatë dy viteve të mandatit të saj poetja do të udhëheqë misionin për të qasur lexuesin drejt librit, poezisë, gjuhës. Shpallja e këtij titulli ishte edhe aktiviteti përmbyllës i Tetorit të Librit, një muaj aktivitetesh shtrirë në gjithë Shqipërinë, nën moton

"Fjalë pas fjale". Përgjatë këtij muaji pati promovime librash, festivalet letërsie, takime me shkrimtarë etj. Ky muaj e gjeti Tiranën me një qendër më shumë për librin, Qendrën "Sotir Kolea", dhe projektin e rehabilitimit të fondit të Bibliotekës Kombëtare. Një lajm i mirë që do t'i japë zgjidhje ngërçit të hapësirave për ruajtjen e librave, deri në momentin e ngritjes së një Biblioteke të re, që i jep fund kësaj problematike të mbartur në dekada.